



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.07.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Rruga 07 LLC, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale”, Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Rruga 07 LLC e dt.17.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale”, Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 24.06.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Përmirësohet** pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 24.06.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e pjesërisht të Dosjes së tenderit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Rruga 07 LLC., me dt.17.07.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale”, Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.07.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Pajisja nr. 18. - Pirunjer me peshe totale 6t , pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i bazuar - korrigjohet dhe bëhet deri në 6t.

2. Pajisja nr. 26. – Kove qe montohet ne eskavator me sistem hidraulik per perzierjen e betonit 1m³, pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i bazuar - korrigjohet dhe bëhet deri 1m³,
3. Pretendimi juaj lidhur me licencën , është pjesërisht i bazuar korrigjohet dhe bëhet :

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca valide për a) Prodhimin të betonit ose marrëveshje për furnizim nga operator i licencuar për prodhim të betonit,b) Shfrytëzimi të rërës dhe zhavorrit ose gurthyes ,ose marrëveshje për furnizim nga operator i licencuar për shfrytëzim të rërës dhe zhavorrit ose gurthyes.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit te Komunës;

Te gjitha palëve te interesuara;